Kronikë

# Shkodër, motër e vëlla i vunë tritol biznesmenit në derën e banesës dhe tek agjencia funerale, në kërkim 35-vjeçari, arrestohet e motra! Zbardhet motivi: Donin t'i merrnin para (EMRI)

*Prokuroria e Shkodrës thotë se motër e vëlla nuk kanë vepruar të vetëm për vendosjen e lëndës plasëse në dy raste në pronat e Ardian Fierzës, një rast në biznesin e tij agjenci funerale në gusht të këtij viti dhe rasti tjetër në nëntor të po këtij viti në banesën e tij.*

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Redaksia
3 Dhjetor, 10:38 | Përditësimi: 3 Dhjetor, 16:13

Share

**Shkodër**- Motër e vëlla akuzohen se janë autorë të vendosjes së lëndës plasëse në dy raste në pronat e Ardian Fierzës, një rast në biznesin e tij agjenci funerale në gusht të këtij viti dhe rasti tjetër në nëntor të po këtij viti në banesën e tij.

Policia e Shkodrës informoi sot se shpalli në kërkim **Benard Pllumbaj**, 35 vjeç ndërsa u arrestua motra e tij Lumturi Pllumbaj e cila akuzohet si bashkëpunëtore. Policia e Shkodrës zbardh dhe motivin.

> *" Bazuar në provat e sigurueara gjatë hetimit proaktiv, rezultoi se autori i dyshuar edhe për rastin e dytë të vënies së lëndës plasëse, është shtetasi Benard Pëllumbaj, 35 vjeç. Në vijim të hetimeve rezultoi se ky shtetas ka bashkëpunuar me motrën e tij, shtetasen Lumturi Pllumbaj, për marrjen e një shume parash nga shtetasi **Ardian Fierza**, me të cilin kishte konflikt pronësie për angjencinë funerale" informoi sot policia.*

**Dy shpërthimet**

LEXO EDHE:
**Shkodër/ Banesa iu përfshi nga flakët, humb jetën 80- vjeçari! Mbeti i bllokuar brenda shtëpisë ku jetonte i vetëm**

Më 10 nëntor 2024 një sasi eksplozivi shpërtheu në orët e para të mëngjesit para banesës së Aridianit. Por kjo nuk ishte hera e parë, pasi **më 29 gusht 2024**, një sasi *eksplozivi* u vu tek dera e agjencisë funerale Flora Fierza , në pronësi të Ardian Fierza i cili sapo e kishte hapur si biznes. Ps kësaj ngjarje policia shpalli në kërkim një Benard Pllumbaj si autor i vendosjes së tritolit.

Theksojmë se **Policia** ka të gjithë episodin e filmuar kur 35 vjeçari vendos lëndën plasëse agjencinë funerale. Nga pamjet e sigurueara autori, është afruar pranë agjencisë i maskuar, ka ndezur lëndën plasëse, e ka hedhur në derën e agjencisë funerale dhe më pas është larguar i qetë.

**Motër e vëlla, i gjejnë kanabis e armë**

Gjatë kontrollit në banesën e Benard Pllumbaj, me precedent penal për armëmbajtje pa leje bluté gjetën dhe sekuestruan 1 armë zjarri pistoletë, municion luftarak, 1 radio dore si e Policisë, 1 laptop, 1DVR dhe 11 celularë. Ndërkohë *gjatë kontrollit në subjektin që administronte (paruker), u gjetën dhe sekuestruan 0.5 kg lëndë narkotike kanabis*

**Ka dhe të tjerë**

Prokuroria e Shkodër, ka regjistruar procedimin penal nr.1265 të vitit 2024, për dyshime të kryerjes së veprave penale 'Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë', 'Shkatërrimi i pronës me eksploziv' dhe 'Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit', parashikuar nga nenet 109/b, 152 dhe 278/p.1 të Kodit Penal, në dëm të Ardian Fierzës. Ndërkohë dyshohet se janë dhe persona të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje.

> *"Në kuadër të veprimeve hetimore të kryera deri më tani, në drejtim të zbardhjes së ngjarjeve, Prokuroria pranë Gykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Shkodër ka kryer arrestimin e shtetasex **Lumturi Pllumbaj**. Kjo shtetase, dyshohet se ka bashkëpunuar me vëllanë e saj, Benard Pllumbaj, si dhe me persona të tjerë të përfshirë në ngjarje me qëllimin për të shtrënguar me anë të kanosjes shtetasin Ardian Fierza për të përfituar padrejtësisht pasuri. Dyshimet e arsyeshme bazohen në provat e administruara deri më tani si rezultat i aplikimit edhe të metodave speciale të hetimit"*

**Te akuzuar për shperthimet ne banesen e biznesin e Fierzës**

**Benard Pllumbaj - Ne kerkim** akuzohet për veprat penale "Shkatërrimi i pronës me eksploziv", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", "Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë", kryer në bashkëpunim, "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", kryer në bashkëpunim, dhe "Ndërhyrje të padrejta në jetën private",
**Lumturi Pllumbaj - E arrestuar** akuzohet për veprat penale "Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë", kryer në bashkëpunim, "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", kryer në bashkëpunim, dhe "Ndërhyrje të padrejta në jetën private".

Prokuroria e Shkodrës bën me dije se janë duke u kryer veprimet të tjera hetimore për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe identifikimin e autorëve të tjerë të kryerjes së veprës penale.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: flora fierza | Benard Pllumbaj | tritol | Shkoder | ardian fierza | Lumturi Pllumbaj

Komento

## Komente

Iris: 04/12/2024 01:19
E kam thene dhe ne nje koment te meparshem,qe kjo dukej si gjobe dhe ja ku u vertetua,tani duhet pare nese ky ishte viktima e vetme,apo keta e kane bere /biznes/ dhe me viktima te tjera.
Përgjigju

Ndalohet reprëtësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
5 Dhjetor, 08:50
Beteja në Kushtetuese, a duhet që listat për deputetë të hapen plotësisht?
Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Hapet traseja e rrugës së re Shirokë-Zogaj, shkon deri në pikën kufitare me Malin e Zi (VIDEO)
4 Dhjetor, 16:55

Zbulohet shtëpi bari në Vaun e Dejës, sekuestrohet 140 kg kanabis! Në pranga pronari, djali i tij dhe 2 nipat (VIDEO)
4 Dhjetor, 11:10

Hapet traseja e rrugës nga pika kufitare me Malin e Zi deri në Zogaj, Rama: Do të këtë trotuar dhe korsi biçikletash
4 Dhjetor, 11:05

Dinamo i viziton në Shkodër, Thomas Brdaric: Të mbetemi të pamposhtur në shtëpi, Gurishta ka mbyllur vitin! Futemi në merkato
3 Dhjetor, 11:31

Pukë/ Punëtori i vë aksidentalisht flakën servisit duke salduar! Digjet automjeti, plagoset edhe vetë
2 Dhjetor, 19:51

VIDEO/ Punimet drejt fundit, 'Tregu i Rusit' në Shkodër hapet më 15 dhjetor
Ergys Kavaja
2 Dhjetor, 13:27

Vlora e Shkodra çelin siparin e festave, ndizen dritat! Qytetet 'vishen' me dekorin festiv
1 Dhjetor, 19:29

Aksident në aksin Lezhë-Shkodër/ Makinat përplasen me njëra tjetrën, plagosen drejtuesit e automjeteve
1 Dhjetor, 17:39

Reshje borë në Shkodër, qarkullimi pa probleme drejt Thethit e Bogës! Borëpastrueset në terren
1 Dhjetor, 10:23

Shkodër/ Braktisën makinën me emigrantë dhe largohen pas thirrjes së policisë për të ndaluar, në kërkim dy persona
30 Nëntor, 14:24

Turizmi i bardhë, nis sezoni i skive në Dardhë të Korçës! Lëvizja e mjeteve vetëm me goma dimërore! Reshjet e dëborës në 'Rugën e Kombit', policia apelon: Pajisuni me zinxhirë
30 Nëntor, 08:59

Moti i keq/ Reshje shiu në mbarë vendin, në zonat malore borë! Gurë e inerte në rrugë, ARRSH: Kujdes në qarkullim
29 Nëntor, 15:56



© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje